



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**  
**Nr. 18, Dt. 21.05.2010**

*Per miratim te lejes, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Drino, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatrave Terihat dhe Gorice (ne lindje te tij), subjektit "Euro Beton" sh.p.k. komuna Dropulli i Poshtem, Qarku Gjirokaster.*

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Euro Beton" sh.p.k, konform formularit "E", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

1- Te miratoj lejen, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Drino, ne afersi te fshatrave Terihat dhe Gorice (ne lindje te tij), Komuna Dropulli i Poshtem, subjektit "Euro Beton" sh.p.k. Gjirokaster.

2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim do te jete 0.096 km<sup>2</sup>, per 5 vjet.  
E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte:

X 1 = 44 28 750

Y 1 = 44 35 526

X 2 = 44 28 888

Y 2 = 44 35 318

X 3 = 44 28 920

Y 3 = 44 35 340

X 4 = 44 28 722

Y 4 = 44 35 548


3- Leja jepet nje afat 5 vjecar me te drejte rinovimi pas tre vjetesh, ne dt. 21.05.2013.

4-Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2010 deri me 31.10.2010, duke u ricikluar cdo vit, deri me dt. 21.05.2013 (periudha qe subjekti "Euro Beton" sh.p.k, duhet te aplikoj per rinovimin e kesaj leje)

• *Vazhdim i Vendimit Nr. 18, Dt. 21.05.2010.*

- 5- Volumi i materialit qe do te merren per 3 vjet do te jete 60 000 m<sup>3</sup>, me nje mesatare vjetore 20 000 m<sup>3</sup>/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.
- 6- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.
- 7- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJES I A.U.B “VJOSE”**  
**Ardian DINE**



**KRYETARI I K.B.U “VJOSE”**  
**Hasan HALILI**

